



VENDIM

Nr. 127, Datë 29.07.2016

**MBI KËRKESËN E KESH SH.A. PËR ANULLIMIN VENDIMIT NR. 103,
DATË 23.06.2016, “MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 16 pikat 1 dhe 5, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e KESH sh.a. për anulimin Vendimit Nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik,

Konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a., me anë të shkresës Nr. 5703 /1 Prot., datë 12.07.2016, i është drejtuar ERE-s, me një ankim administrativ mbi Vendimin Nr. 103, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi Miratimin e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Ky vendim i është komunikuar shoqërisë KESH sh.a. nëpërmjet shkresës Nr. 496 Prot., datë 29.06.2016 të ERE-s.
- Mbështetur në nenin 16 pika 5 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenin 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin Nr. 96 datë 17.06.2016 të Bordit të ERE: *Për një Vendim te Bordit, Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni te vendimit.*
- Kërkesa e KESH sh.a. per anulimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 103 datë 23.06.2016 është depozituar në ERE jashtë afateve ligjore.
- Nuk është paraqitur asnjë prove e re që të cojë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshem nga Vendimi Nr 103 date 23.06.2016 i Bordit të ERE.
- Vendimi Nr 103 date 23.06.2016 i Bordit të ERE reflekton parashikimet e ligjit 43/2015 “Per sektorin e Energjise elektrike” si dhe legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së Shoqërisë KESH sh.a. për anulimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi Miratimin e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.